

NJOFTIM

për shpalljen e vlerësimit të dosjeve për kandidatët në portalin “Mësues për Shqipërinë” 2022

Rezultatet e vlerësimit të dosjeve për kandidatët në portalin “Mësues për Shqipërinë” 2022, të cilët kanë dorëzuar dosjen në DRAP Fier shpallen online në faqen **fier.arsimiparauniversitar.gov.al**.

Në zbatim të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, kandidati do të identifikohet vetëm me numrin e ID në portalin “Mësues për Shqipërinë” sipas shtojcës 4 në sistem dhe me profilin për të cilin ka aplikuar.

Për kandidatët që kanë mbartur pikët e dosjes nga portali 2021, NUK ËSHTË BËRË VLERËSIM DOSJEJE gjatë procesit të vlerësimit në portalin 2022.

Kandidatët e skualifikuar njihen edhe me arsyen e skualifikimit.

Në datën 20.6.2022 publikohet tabela me rezultatet paraprake.

Mbi bazën e këtyre rezultateve aplikantët, të cilët kanë ankesë për vlerësimin, mund të drejtojnë ankesën e tyre:

- a) Me shkrim në adresën e DRAP Fier
- b) Me email në adresën **portali2022fier@gmail.com** (e krijuar enkas për këto raste)

Ankesa të përmbajë elementet e detyrueshme si vijon:

Emri, mbiemri i aplikantit që ankohet _____

ID e aplikantit në portal _____

Profili _____

ZVAP e vendbanimit _____

Objekti i ankimit:

<i>Rubrika për të cilën ankimon rezultat</i>	<i>Pikë në sistem</i>	<i>Pretendimi i ankuesit për këtë rubrikë</i>
<i>Nota mesatare</i>		
<i>Shkalla e kualifikimit</i>		
<i>Gjuhët e huaja</i>		
<i>Certifikata trajnimesh</i>		
<i>Vjetërsi pune si mësues ose drejtues i IA-ve</i>		
<i>Skualifikimi</i>		

Afati i ankimeve është data 24.6.2022.

Ankuesit, pas marrjes së përgjigjes, duhet të konsultohet me tabelën përfundimtare që do të publikohet pas datës 24.6.2022.